



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR

Nr. 147, Datë 02.10.2019

PËR MIRATIMIN E FLETËS TIP TË VOTIMIT PËR ANËTARIN PROKUROR  
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Në mbështetje të nenit 148/ b, shkronja "dh" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 114, pika 2 të ligjit nr.115/ 2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e fletës tip të votimit që përmban emrat e kandidatëve për anëtar prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtorja e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Drejtorja e Teknologjisë dhe Informacionit për t'i siguruar Komisionit të Votimit, mjetet e nevojshme për shumëfishimin e fletëve të votimit në kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes
3. Të njihen me këtë urdhër të gjithë prokurorët.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU



**FLETË VOTIMI**  
**ZGJEDHJA E ANËTARIT PROKUROR TË**  
**KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

---

**Kandidatët nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë**

<b>Nr</b>	<b>Emër Mbiemër</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Shënimi i votuesit</b>
<b>1</b>	<b>ESMERALDA KESHI (CAMI)</b>	<b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë DIBËR</b>	
<b>2</b>	<b>VLADIMIR MARA</b>	<b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë PËR KRIMET E RËNDA</b>	

**KOMISIONI I VOTIMIT:**

**Anëtar**

**Kryetar**

**Anëtar**

Shënim:

- Votohet duke vendosur në kutinë përbri emrit të kandidatit një nga shenjat “+” ose “x” ose “√”. Në fletën e votimit të mos bëhen shënime të tjera përveç shenjës së votimit, pasi çdo shënim tjetër e bën votën të pavlefshme;
- Qohen të pavlefshme fletët e votimit kur:
  - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;
  - b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;
  - c) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;
  - ç) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.